



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE

Nr. 196 prot.

Tiranë, më 15.03.2023

UDHËZIM

Nr. 1 datë 15/03/2023

MBI PËRFUNDIMIN E AKTIVITETIT TË OFRUESIT TË KUALIFIKUAR TË SHËRBIMIT TË BESUAR DHE TRANSFERIMIN E SHËRBIMIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, Ligjit nr. 107/2015, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 27.1.2016, "Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurine Kibernetike,

Udhëzon:

Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, për zbatimin e procedurave dhe rregullave që duhet të ndiqen prej tyre në rastin e përfundimit të aktivitetit dhe/ose transferimit të shërbimit tek palët e treta.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, me qëllim garantimin e integritetit të të dhënave të menaxhuara nga Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, gjatë procesit të transferimit të shërbimit ose ndërprerjes së veprimtarisë duhet mbështetet në detyrat si më poshtë:

1. Verifikon planet e përfundimit të aktivitetit në rastet kur ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar ndërpret aktivitetin e tij, duke përfshirë:

- o mënyrën se si informacioni mbahet i aksesueshëm për një periudhë të paktën 7 vjeçare pas përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës dhe pas ndërprerjes së veprimtarisë së OKSHB
- o mënyrën se si ruhet informacioni relevant mbi të dhënat e lëshuara dhe të marra nga Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, me qëllim përdorimin e tyre në procedura ligjore, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit.

2. Verifikon raportin e vlerësimit të konfirmimit të lëshuar OTK dhe në mungesë të këtij të fundit, ndjek transferimin e procesit duke u mbështetur në programin e kontrollit dhe harton një raport mbi të.
3. Në rastet e transferimit të shërbimeve të besuara tek palët e treta, kur kjo e fundit nuk ka statusin i "kualifikuar", merr në shqyrtim dokumentacionin e nevojshëm për akreditim, dhe brenda 5 ditëve miraton ose jo statusin "i kualifikuar", si dhe përditëson listën e besuar.

Detyrat e OKSHB kur ndërpret veprimtarinë ose e transferon shërbimin tek një OKSHB tjetër

1. Për të garantuar sigurinë e informacionit dhe minimizimin e impaktit të ndërprerjes së shërbimeve të besuara, duhet të mbështetet mbi një plan të miratuar masash të hartuara prej tij, i cili do të sigurojë edhe vazhdimësinë e shërbimit. (Aneksi Nr.1, *Plani i përfundimit të aktivitetit si OKSHB*)
2. OKSHB mund të ndërpresë pjesërisht ose plotësisht ofrimin e shërbimeve të kualifikuara të besuara. Ndërprerja e pjesësisht përfshin përfundimin e një ose më shumë shërbimeve të besuara të përfshira në listën e besuar.
3. OKSHB është i detyruar të informojë AKCESK për arsyen e përfundimit të aktivitetit, procesin e transferimit nëse ka, si dhe të dhënat e subjektit të cilit mund ti transferohet shërbimi.
4. OKSHB regjistron dhe mban të aksesueshme për një periudhë të paktën 7 vjeçare pas përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës dhe pas ndërprerjes së veprimtarisë, të gjithë informacionin relevant mbi të dhënat e lëshuara dhe të mbledhura, me qëllim përdorimin e tyre në procedura ligjore, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit. Një regjistër i tillë mund të mbahet në mënyrë elektronike;
5. OKSHB që përfundon aktivitetin do të mbajë ose do t'i transferojë OKSHB tjetër çdo detyrim të tij me palët e treta, duke ju vënë në dispozicion edhe çelësin e tij publik, ose token e shërbimit të besuar, gjatë periudhës tranzitore. Me përfundimin e procesit të transferimit, çelësi publik duhet të shkatërrohet dhe të gjenerohet çelësi përkatës në emër të ofruesit të ri.
6. Përpara se një OKSHB të transferojë shërbimin të tij, duhet të dokumentojë shkatërrimin e çelësve privatë, të cilët nuk janë të vlefshëm duke përfshirë edhe kopjet backup, në një mënyrë të tillë që çelësat privatë të jenë të pakthyeshmen për përdorim.
7. Në rastin e ndërprerjes së veprimtarisë, të gjitha çelësat private dhe ai publik, do të shkatërrohen. Procedura e shkatërrimit të çelësve do të dokumentohet nga OKSHB.
8. Për certifikatat elektronike në përdorim, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri të përfundimin e afatit të vlefshmërisë të tyre.

Detyrat e OKSHB së kualifikuar të cilës i transferohet shërbimi

OKSHB të cilës i është transferuar shërbimi mund të përdorin asetet e marra (Asetet mund të përfshijnë hardware dhe software që lejojnë ofrimin e shërbimeve të besuara, bazën e të dhënave të klientëve dhe sistemet e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët, kontratat e furnitorëve, etj). për të ofruar shërbimet e besuara, me kusht:

- Përsa i përket certifikatave të kualifikuara të lëshuara nga OKSHB, mund të mos kryhet revokimi i të gjitha certifikatave ekzistuese dhe të parevokuara që janë lëshuar nga OKSHB që ka përfunduar aktivitetin për një afat të caktuar kohor.
- OKSHB merr përgjegjësitë mbi Kushtet dhe detyrimet e OKSHB ku përfshihet: çdo referencë e OKSHB që ka përfunduar aktivitetin (d.m.th. emri dhe numri i regjistrimit në të dhënat zyrtare) duhet të konsiderohet, për të identifikuar OKSHB pasardhëse (të paktën për shërbimin(ët) e përfunduara të OKSHB).

Detyrat e subjektit të ri të cilit i transferohet shërbimi

- Subjekti i ri duhet të nënshtrohet procesit të akreditimit për ushtrimin e veprimtarisë si OKSHB, proces i cili duhet të ndërmerret përpara ofrimit të shërbimit të besuar.
- Subjekti i ri garanton dokumentimin e procesit të gjenerimit të çelësit publik në emër të tij, menjëherë pas përfundimit të procesit të transferimit të shërbimit.
- Subjekti i ri duhet të paraqesë pranë AKCESK dokumentacionin e parashikuar në legjislacionin në fuqi¹ për shërbimet e besuara për përfitimin e statusit OKSHB, menjëherë kur fillon procesin e transferimit të shërbimit nga një OKSHB.
- Subjekti që i transferohet shërbimi, duhet të paraqesë pranë AKCESK së bashku me dokumentacionin një kopje të raportit të vlerësimit të konformitetit të lëshuar nga një OTK. Në rast të mungesës së një OTK, AKCESK verifikon procesin e konformitetit të subjektit i cili synon të ofrojë shërbime “të kualifikuara” të besuara, nëpërmjet inspektimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Menjëherë pas marrjes së statusit “i kualifikuar”, OKSHB në fjalë ofron lëshimin e certifikatave të kualifikuara për aplikuesit. OKSHB e konfirmuar është pjesë e Listës së Besuar e cila publikohet në faqen zyrtare të AKCESK.

Aneksi 1

Plani i përfundimit të aktivitetit si OKSHB përmban:

- a) Specifikimin e procedurave për përfundimin e një, disa ose të gjitha shërbimeve të besuara të ofruara nga një OKSHB.
- b) Adresimin e shërbimeve përkatëse të përmendura në pikën a, në renditjen në listën e besuar dhe ndikimi i përfundimit të shërbimit.
- c) Procedurat e pikës (a) duhet të sigurojnë që:
 - (i) asnjë certifikate elektronike nuk mund të krijohet më, duke përdorur të dhënat e krijimit të nënshkrimit/vulës të OKSHB që ka përfunduar veprimtarinë.

¹ <https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/ligji9880.pdf>
<https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/ligji107.pdf>
<https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/VKM69.pdf>
<https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/udh%C3%ABzim1.pdf>

- (ii) certifikatat ekzistuese dhe të parevokuara të lëshuara nga OKSHB që përfundon aktivitetin revokohen, me përjashtim të rasteve kur veprimtaria i transferohet një OKSHB tjetër.
- d) Procedurat dhe masat për disponueshmërinë e të dhënave të tij për një periudhë kohore prej 7 vitesh, përfshin të gjithë informacionin mbi të dhënat e lëshuara dhe të marra nga OKSHB, për qëllim garantimin e provave në procese ligjore dhe me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, në veçanti të dhënat e verifikimit të vlefshmërisë së nënshkrimit/vulës së OKSHB dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të informacionit të kërkuar për të verifikuar saktësinë e produkteve të besuara të krijuara më parë.
 - e) Ndërprerjen vullnetare dhe të jo vullnetare
 - f) Adresimin në mënyrë të qartë të skenarëve të identifikuar për përfundimin e ofrimit të shërbimeve të besuar.
 - g) Masat për të siguruar transferimin e shërbimit tek një OKSHB tjetër në mënyrë që përdoruesit e shërbimit të marrin pa ndërprerje shërbime të besuara.
 - h) Dispozita mbi njoftimin për palët e përfshira.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Igli TAFA

